



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave

S h k u r t 2 0 1 5 / N R . 1 2

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave

(bazuar në të dhënat e raportuara nga bankat komerciale në baza të rregullta periodike)

BOTUES ©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Sistemit të Pagesave
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE payment.systems@bqk-kos.org

Gjylfidane Kastrati-Kadrijaj, Drejtore e Departamentit të
Sistemit të Pagesave
Masar Baxhaku, Analist për Mbikëqyrje të Sistemit të Pagesave

SHKURTESAT:

ATM	Bankomat
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DD	Debitim Direkt
DSP	Departamenti i Sistemit të Pagesave
EFT-POS	Transfer Elektronik i Mjeteve në Pikë të Shitjes
POS	Pikë e Shitjes
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar

INFORMATË:

Për përshkrim të detajuar, referohuni shënimeve sqaruese.
Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës,
Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave, nr. 12, Prishtinë 2015.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.
Ky publikim përfshin të dhëna në dispozicion deri më 31 dhjetor 2015.

PËRMBAJTJA

HYRJE	06
1. Transaksionet ndërbankare	07
1.1. Vëllimi dhe vlera e transaksioneve ndërbankare	07
2. Numri i llogarive bankare	11
2.1. Llogaritë e-banking	12
2.2. Urdhëresat periodike	15
2.3. Debitimi Direkt	15
3. Terminalet ATM dhe POS	16
4. Numri i kartelave	18
5. Transaksionet me kartela	19

PREZANTIMI GRAFIK

1. Përqindja e transaksioneve (sipas numrit)	09
2. Përqindja e transaksioneve (sipas vlerës)	09
3. Numri i transaksioneve të rregullta (në milionë)	10
4. Vlera e transaksioneve të rregullta (në miliardë euro)	10
5. Numri i transaksioneve ndërbankare (në milionë)	10
6. Vlera e transaksioneve ndërbankare (në miliardë euro)	10
7. Numri i llogarive bankare (në milionë)	11
8. Numri i llogarive e-banking	13
9. Numri i transaksioneve e-banking (në mijëra)	14
10. Vlera e transaksioneve e-banking (në miliardë)	14
11. Urdhëresat periodike	15
12. Debitimi Direkt	16
13. Numri i terminaleve POS	17
14. Debit dhe kredit kartelat	19
15. Numri i përgjithshëm i kartelave	19

TABELAT STATISTIKORE

1. Numri i transaksioneve ndërbankare	08
2. Vlera e transaksioneve ndërbankare	08

3. Numri i llogarive bankare -----	11
4. Numri i llogarive e-banking sipas llojit -----	14
5. Numri i terminaleve ATM -----	17
6. Numri i terminaleve POS-----	17
7. Numri i kartelave sipas funksionit -----	18
8. Numri i transaksioneve me kartela -----	20
9. Vlera e transaksioneve me kartela -----	21
Përfundim -----	22

Hyrje

Sistemi i pagesave i qëndrueshëm dhe i sigurt, është element kyç dhe luan rol të rëndësishëm në efikasitetin dhe stabilitetin e sektorit financiar në Kosovë, si dhe ekonominë e vendit si tërësi. Prandaj, sigurimi i funksionimit normal të sistemeve të pagesave është një nga objektivat dhe detyrë e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Sistemi i pagesave në Kosovë edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të operojë me shkallë të lartë të efikasitetit dhe të sigurisë, duke mundur kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe të letrave me vlerë në përputhje me rregullat dhe standardet në fuqi.

Besimi i publikut në sistem të pagesave, ka ndikuar në rritjen e numrit dhe vlerës së pagesave ndërbankare të procesuar përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN). Si rezultat i operimit efikas dhe të sigurt të SEKN-së, mesatarja ditore e numrit të pagesave të procesuara përmes këtij sistemi në fund të vitit 2014 ka qenë 37,445 transaksione, ndërsa mesatarja ditore e vlerës së pagesave në SEKN gjatë kësaj periudhe ka qenë 25.34 milionë euro.

Në pjesën e parë të kësaj analize janë prezantuar të dhënat për numrin dhe vlerën e transaksioneve ndërbankare të realizuara përmes SEKN-së, si dhe pjesëmarrja e secilit modul të pagesave në vlerën e përgjithshme të transaksioneve ndërbankare.

Në pjesën e dytë, janë prezantuar dhe analizuar të dhëna për numrin e llogarive bankare të ndara sipas statusit të mbajtësve të llogarive, të dhënat për numrin e llogarive të cilave klientët mund t'iu qasen përmes internetit, si dhe numrin dhe vlerën e transaksioneve të realizuara përmes internetit dhe transaksionet e realizuara përmes Debitimit Direkt.

Në pjesën e tretë, janë analizuar gjerësisht zhvillimet e infrastrukturës së terminaleve për pagesa (ATM dhe POS). Po ashtu, është paraqitur shpërndarja e tyre sipas regjioneve të Kosovës, nga edhe mund të shihet për koncentrimin e tyre nëpër regjione të ndryshme.

Në pjesën e katërt janë paraqitur dhe analizuar të dhënat për numrin e kartelave për pagesa në Kosovë, si dhe për numrin dhe vlerën e transaksioneve të realizuara me kartela. Në vijim është paraqitur edhe ndarja e kartelave sipas funksionit që kryejnë, sipas gjinisë dhe moshës së poseduesve të tyre.

1. Transaksionet ndërbankare

Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK). Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN) është sistem hibrid i pagesave, përmes të cilit kanalizohen, si pagesat me vlerë të vogël po ashtu edhe ato me vlera të mëdha.

Vëllimi dhe vlera e transaksioneve të procesuara përmes SEKN-së vazhdimisht është në rritje, që mund të arsyetohet me efikasitetin dhe sigurinë e lartë që ofron ky sistem. Në vazhdimësi, SEKN-ja ka pësuar ndryshime duke iu përshtatur kushteve të reja dhe zhvillimeve teknologjike, të cilat kanë mundësuar që sot SEKN-ja të jetë sistem i automatizuar i përpunimit të të dhënave mbi transaksionet e pagesave ndërbankare (kliringun dhe shlyerjet në llogari).

1.1. Vëllimi dhe vlera e transaksioneve ndërbankare

Nga të dhënat statistikore të analizuara në këtë raport, mund të konstatohet për rritjen e vazhdueshme të numrit të transaksioneve ndërbankare për secilin lloj të pagesave.

Pagesat e rregullta individuale kanë pasur një tendencë të qëndrueshme rritjeje nga viti në vit, gjë që ka ndikuar edhe në rritjen e përgjithshme të transaksioneve ndërbankare.

Pagesat prioritare individuale, të cilat kryesisht janë pagesa në vlera më të mëdha dhe të cilat kryhen për një kohë relativisht të shpejtë, gjithashtu kanë shënuar rritje të vazhdueshme nga periudha në periudhë.

Pagesat Kos-Giro, fillimisht ishin të pranuar nga një numër i limituar i kompanive. Megjithatë me kalimin e kohës numri i kompanive që përdornin Kos-Giro u rrit, gjë që ndikoi edhe në rritjen e numrit dhe vlerës së transaksioneve Kos-Giro. Sot këto transaksione përfaqësojnë një pjesë shumë të rëndësishme të sistemit të pagesave.

Në tabelën 1 është paraqitur numri i transaksioneve ndërbankare për secilin modul të pagesave, që nga viti 2010 deri në fund të vitit 2014.

Tabela 1. Numri i transaksioneve ndërbankare

Lloji i transaksioneve	2010	2011	2012	2013	2014
Të rregullta	615,700	727,668	833,409	970,717	1,032,043
Prioritare	15,145	18,657	22,300	24,812	26,079
Të rregullta-masive	2,872,234	2,937,845	2,916,145	3,294,677	3,731,436
Prioritare-masive	2,021	2,091	3,873	1,797,330	3,233,049
Pagesat xhiro	419,329	496,197	543,338	692,281	1,013,620
Letrat me Vlerë	-	-	309	498	618
Debitimi Direkt	3,303	7,321	10,304	13,115	14,582
Totali	3,927,732	4,189,779	4,329,678	6,793,430	9,051,427

Burimi: BQK (2015)

Numri i përgjithshëm i transaksioneve ndërbankare gjatë vitit 2014 arriti në rreth 9.05 milionë transaksione. Faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen e numrit të transaksioneve ndërbankare të SEKN-së gjatë kësaj periudhe është procesimi i pagave të shërbyesve të administratës publike, si dhe pagesave për kategoritë e skemave sociale të MPMS-së përmes këtij sistemi.

Edhe gjatë viteve të mëparshme kishte rritje të numrit të transaksioneve të procesuara përmes SEKN-së por me trend më të ngadalshëm krahasuar me këtë periudhë.

Pagesat e rregullta individuale gjatë kësaj periudhe vazhduan me trend rritës, numri i tyre kaloi mbi një milionë transaksione. Me trend të rritjes u karakterizuan edhe llojet e tjera të transaksioneve: numri i pagesave prioritare arriti në 26.1 mijë transaksione, të rregullta masive 3.73 milionë, Kos Giro mbi një milionë transaksione, Debitimi Direkt 14.6 mijë transaksione, të cilat gjithnjë e më shumë po bëhen pjesë e rëndësishme e SEKN-së.

Numri dhe vlera e pagesave masive prioritare gjatë kësaj periudhe shënoi rritje të shpejtë, pasi që nga kjo periudhë filloi procesimi i pagave të shërbyesve të administratës publike, si dhe pagesave për skemat sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) duke eliminuar format më pak efikase për transfere të përdorura deri në këtë kohë.

Tabela 2. Vlera e transaksioneve ndërbankare

Lloji i transaksioneve	2010	2011	2012	2013	2014
Të rregullta	2,949,927,890	3,089,861,523	3,161,880,010	3,319,527,253	3,329,886,961
Prioritare	568,863,646	652,651,299	893,490,615	768,577,986	666,722,026
Të rregullta-masive	402,854,279	465,187,794	470,361,458	531,795,573	536,499,429
Prioritare-masive	1,386,264	1,434,815	2,397,909	374,517,269	645,334,638
Pagesat xhiro	734,367,964	871,170,119	892,130,913	899,986,956	949,316,256
Letrat Me Vlerë	-	-	252,653,198	534,011,408	695,370,096
Debitimi Direkt	2,807,939	6,252,068	8,043,429	6,763,903	7,182,931
Totali	4,660,207,982	5,086,557,617	5,680,957,532	6,435,180,348	6,830,312,337


Burimi: BQK (2015)

Në tabelën 2 është paraqitur vlera e transaksioneve ndërbankare nga viti 2010 e deri në fund të vitit 2014. Vlera e përgjithshme e transaksioneve ndërbankare gjatë këtij viti arriti vlerën e rreth 6.83 miliardë euro. Vetëm vlera e pagesave të rregullta individuale kaloi vlerën e 3.32 miliardë euro, ndërsa vlera e moduleve tjera të pagesave ishte më e vogël krahasuar me pagesat e rregullta, por prapëseprapë vlera e tyre ishte më e madhe se në vitin 2013 dhe trendi rritës vazhdon për këto pagesa.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën 1 dhe 2, mund të konstatohet lidhur me peshën e secilit lloj të pagesave në vlerën e përgjithshme të pagesave.


Në vitin 2014, pagesat e rregullta individuale përbëjnë 11.4 për qind të numrit të përgjithshëm të pagesave ndërsa në vlerën e përgjithshme të transaksioneve ndërbankare ato marrin pjesë me 48.75 për qind. Pagesat prioritare individuale zënë vetëm 0.29 për qind të numrit të transaksioneve, ndërsa vlera e tyre përbën rreth 9.76 për qind të vlerës së transaksioneve.

Figura 1. Përqindja e transaksioneve (sipas numrit)



Burimi: BQK (2015)


Figura 2. Përqindja e transaksioneve (sipas vlerës)



Burimi: BQK (2015)


Pagesat e rregullta masive përbëjnë rreth 41.22 për qind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve ndërsa vlera e tyre merr pjesë me 7.85 për qind në vlerën e transaksioneve. Pagesat prioritare masive përbëjnë rreth 35.72 për qind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve ndërbankare ndërsa vlera e tyre rreth 9.45 për qind të vlerës së transaksioneve ndërbankare. Debitimi Direkt merr pjesë me më pak se 1%, si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve ndërbankare. Pagesat Kos Giro vazhdojnë të jenë pjesë shumë e rëndësishme e sistemit të pagesave: numri i tyre përbën 11.20 për qind të numrit të transaksioneve, ndërsa vlera e tyre përbën 13.90 për qind të vlerës së transaksioneve ndërbankare. Letrat me vlerë marrin pjesë me numër shumë të vogël (rreth 0.01 për qind), por vlera e tyre përbën rreth 10.18 për qind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve ndërbankare.

Figura 3. Numri i transaksioneve të rregullta (në milionë)



Burimi: BQK (2015)


Figura 4. Vlera e transaksioneve të rregullta (në miliardë euro)



Burimi: BQK (2015)


Në figurat 3 dhe 4 janë paraqitur numri dhe vlera e pagesave të rregullta individuale dhe të rregullta masive nga viti 2009 deri në fundin e vitit 2014. Nga të dhënat e paraqitura në figura, më së miri shihet dallimi mes numrit dhe vlerës së këtyre transaksioneve. Përderisa pagesat e rregullta masive dominojnë në numër ndaj atyre të rregullta individuale, e kundërta mund të thuhet për vlerën e tyre: vlera e pagesave të rregullta individuale dominon përkundrajt pagesave të rregullta masive.

Figura 5. Numri i transaksioneve ndërbankare (në milionë)



Burimi: BQK (2015)

Figura 6. Vlera e transaksioneve ndërbankare (në miliardë euro)



Burimi: BQK (2015)

Në figurat 5 dhe 6 është paraqitur numri dhe vlera e përgjithshme e transaksioneve ndërbankare nga viti 2010 deri në fund të vitit 2014. Si rezultat i funksionimit efikas dhe të sigurt të sistemit të pagesave në Kosovë, numri dhe vlera e pagesave ndërbankare vazhdimisht është në rritje.

2. Numri i llogarive bankare

Shtrirja gjeografike e bankave komerciale në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës ka ndikuar, që qytetarët të kenë më të lehtë qasjen në banka dhe rrjedhimisht pjesa më e madhe e popullatës është e përfshirë në një mënyrë apo tjetër në marrëdhënie me banka (p.sh. kanë llogari bankare, kartela, kredi etj.).

Në fund të vitit 2014, numri i llogarive bankare në Kosovë ishte rreth 1.92 milionë llogari, që në krahasim me numrin e popullsisë do të thotë se afërsisht çdo banor ka një llogari bankare.

Tabela 3. Numri i llogarive bankare

Përshkrimi i Llogarive	2013				2014			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Llogaritë e klientëve	1,826,186	1,839,716	1,876,344	1,855,383	1,853,272	1,878,957	1,903,456	1,917,513
1 - llogari të rezidentëve	1,797,721	1,811,011	1,846,685	1,829,870	1,823,948	1,849,058	1,872,837	1,886,421
a - individuale	1,675,124	1,684,505	1,719,206	1,706,376	1,699,088	1,723,516	1,745,168	1,757,741
b - afariste	122,597	126,506	127,479	123,494	124,860	125,542	127,669	128,680
2 - llogari të jorezidentëve.	28,465	28,705	29,659	25,513	29,324	29,899	30,619	31,092
a - individuale	27,487	27,616	28,782	24,583	28,377	28,909	29,579	30,035
b - afariste	978	1,089	877	930	947	990	1,040	1,057


Burimi: BQQ (2015)

Në tabelën 3 është paraqitur numri i llogarive bankare gjatë 2 viteve të fundit të ndara sipas mbajtësve të llogarive. Në TM4 të vitit 2014 numri i përgjithshëm i llogarive bankare është 1,917,513, ku nga këto llogari 98,37 për qind janë llogari të rezidentëve, ndërsa vetëm rreth 1.63 për qind janë llogari të jorezidentëve. Në krahasim me tremujorin e kaluar, numri i llogarive është rritur për rreth 0.74 për qind. Nëse krahasimin e bëjmë me periudhën e njëjtë të një viti më parë, do të vërejmë se numri i përgjithshëm i llogarive është rritur për rreth 3.35 për qind.

Gjatë vitit 2011 numri i llogarive e kaloi shifrën prej 2 milionë llogari, nëse krahasohet numri i llogarive për vitet 2010 dhe 2011 do të konstatohet rritje e numrit të llogarive për rreth 11 për qind, që paraqet normë mjaft të shpejtë të rritjes së tyre. Në fund të vitit 2012 numri i llogarive bankare ishte 1.82 milionë llogari, që krahasuar me fundin e vitit 2011 paraqet rënie prej 11.4 për qind. Ndërsa, në vitin 2013 numri i llogarive u rrit me 1.7 për qind krahasuar me një vit më parë.

Numri kaq i lartë i llogarive bankare mund të shpjegohet me faktin se një klient mund të ketë llogari në më shumë se një bankë në të njëjtën kohë.

Figura 7. Numri i llogarive bankare (në milionë)




Burimi: BQQ (2015)

2.1. Llogaritë e-banking

Përkundër trendit në rritje, megjithatë Kosova vazhdon të ketë numër relativisht të vogël të përdoruesve të shërbimit e-banking. Në figurën 8 është paraqitur numri i përdoruesve të këtij shërbimi sipas viteve. Norma e rritjes së numrit të llogarive të cilave klientët mund t’iu qasen përmes shërbimit e-banking, në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak (2012) ishte rreth 35.3 për qind, ndërsa një vit më parë norma e rritjes ishte rreth 40.7 për qind. Po ashtu edhe në vitin 2014 numri i llogarive, që klientët mund t’iu qasen përmes internetit pati trend rritës rreth 20.1 për qind krahasuar me fundin e vitit 2013. Bazuar në normën relativisht të lartë të rritjes së përdoruesve të e-banking, mund të konstatohet se në një periudhë kohore relativisht të shkurtër, Kosova do të jetë afër nivelit mesatar në rajon sa i përket përdorimit të shërbimit e-banking. Rritja e numrit të përdoruesve të shërbimit e-banking zvogëlon në masë të madhe edhe pagesat në para të gatshme, i cili është edhe njëri nga qëllimet e institucioneve financiare në vend. Kryerja e transaksioneve përmes shërbimit e-banking është një formë mjaft efikase dhe e sigurt, pasi që klientët kursejnë kohë dhe transaksionet mund t’i kryejnë në çdo kohë dhe nga çdo vend.

Tendenca rritëse e përdoruesve të shërbimit e-banking mund të arsyetohet me angazhimin e shtuar të të gjitha institucioneve financiare për zvogëlimin e pagesave me para të gatshme, përmes fushatave të tyre informuese mbi efikasitetin, sigurinë dhe përparësitë e tjera që ofron ky shërbim.

Figura 8. Numri i llogarive e-banking



Burimi: BQK (2015)

Në tabelën 4 është paraqitur numri i përdoruesve të shërbimit e-banking sipas tipit të llogarive, të ndara në llogari të individëve dhe llogari afariste. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë shihet se nga numri i përgjithshëm i përdoruesve të shërbimit e-banking 80.01 për qind janë llogari, që shfrytëzohen nga personat privatë, ndërsa vetëm 19.99 për qind janë llogari që shfrytëzohen nga ana e bizneseve.

Tabela 4. Numri i llogarive e-banking sipas llojit


Përshkrimi	Numri	%
Llogari individuale	126,223	80.01%
a - individuale (rezident)	122,202	
b - individuale (jorezident)	4,021	
Llogari afariste	31,538	19.99%
a - afariste (rezident)	31,188	
b - afariste (jorezident)	350	
Totali	157,761	100.00%

Burimi: BQK (2015)

Nga tabela po ashtu shihet se nga numri i përgjithshëm i llogarive individuale që përdorin shërbimin e-banking, 96.8 për qind e tyre janë llogari të rezidentëve, ndërsa vetëm rreth 3.2 për qind janë të jorezidentëve. E njëjta mund të thuhet edhe për llogaritë e personave juridikë, ku nga numri i përgjithshëm i tyre rreth 98.9 për qind janë të rezidentëve, ndërsa vetëm 1.1 janë të jorezidentëve.


Në grafikun 9 dhe 10 është paraqitur numri dhe vlera e pagesave të procesuara përmes shërbimit e-banking. Nga të dhënat e paraqitura shihet rritja e shpejtë e numrit dhe vlerës së transaksioneve me e-banking.

Figura 9. Numri e transaksioneve e-banking (në milionë)



Burimi: BQK (2015)

Figura 10. Vlera e transaksioneve e-banking (në miliardë)




Burimi: BQK (2015)

2.2. Urdhëresat Periodike

Numri i llogarive të lidhura me urdhëresa periodike vazhdimisht ka pasur ndryshime edhe pse këto ndryshime kanë qenë me ritëm mjaft të ulët. Nga figura 11 mund të shihet lëvizja e numrit të llogarive të lidhura me urdhëresa periodike sipas viteve. Nëse krahasojmë numrin e llogarive të lidhura me urdhëresa periodike mes vitit 2013 me fundin e vitit 2012, do të konstatohet se ka pasur normë rritëse rreth 10.8 për qind, ndërsa nëse krahasojmë vitin 2012 me vitin 2011 do të shohim se ka pasur rënie prej

rreth 3.1 për qind. Në fund të vitit 2014 numri i llogarive të lidhura me urdhëresa periodike pati rënie për 7.9 për qind krahasuar me fundin e vitit 2013.

Figura 11. Urdhëresat periodike



Burimi BQK (2015)

2.3. Debitimi Direkt

Njëra nga format e reja për kryerjen e disa shërbimeve të caktuara të pagesave është debitimi direkt, skemë kjo e operuar dhe mbikëqyrur nga BQK-ja. Nëse krahasojmë numrin e transaksioneve të Debitimit Direkt në tremujorin e fundit (TM4 2014) me tremujorin përkatës të vitit 2013, do të shohim se ka pasur normë të lehtë rënese prej rreth 5.47 për qind. Ndërsa vlera e transaksioneve përmes skemës së Debitimit Direkt në këtë periudhë ka pasur rritje rreth 22.45 për qind.

Tabela 5. Numri dhe vlera e transaksioneve përmes Debitimit Direkt

Transaksionet ndërbankare të realizuara përmes skemës së Debitimit Direkt	Numër			Vlerë		
	TM4 2013	TM4 2014	Ndryshimi (%)	TM4 2013	TM4 2014	Ndryshimi (%)
	3,871	3,659	-5.47%	1,801,354	2,205,726	22.45%

Burimi: BQK (2015)

3. Terminalet ATM dhe POS

Në tabelën 6 është paraqitur numri i terminaleve ATM nëpër vite nga viti 2010 deri në vitin 2014. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë mund të vërehet rritja e numrit të terminaleve ATM përgjatë viteve. Vitet e para pas luftës së Kosovës u karakterizuan me numër të vogël të terminalëve ATM. Megjithatë, sot kjo situatë është përmirësuar ndjeshëm. Në vitin 2010 norma e rritjes ishte rreth 22.4 për qind, në vitin 2011 norma e rritjes ishte rreth 11 për qind. Numri i ATM-ve kishte normë rritëse edhe për vitin 2012, nëse krahasojmë vitin 2012 me fundin e vitit 2011 do të konstatohet normë e

rritjes prej rreth 5 për qind. Ndërsa gjatë vitit 2013, trendi i rritjes së numrit të terminaleve ATM ishte rreth 2.7 për qind.

Në fund të vitit 2014 numri i terminaleve ATM arrit në 498, që krahasuar me një vit më parë paraqet rritje prej rreth 0.4 për qind. Shumica e terminaleve ATM që janë instaluar në Kosovë ofrojnë funksionin e tërheqjes, ndërsa 13 prej tyre ofrojnë edhe mundësinë e deponimit.


Tabela 6. Numri i Terminaleve ATM

Terminalet sipas funksionit	2010	2011	2012	2013	2014
Automated Teller Machines (ATM)	415	460	483	496	498
prej të cilave:					
1 - ATM me funksion tërheqje cash	415	460	483	496	498
2 - ATM me funksion të pagesave Kos-Giro	39	69	73	70	50
3 - ATM me funksion depozitim cash	0	1	1	8	13

Burimi: BQK (2015)

Në grafikun 12 është paraqitur shpërndarja e rrjetit të terminaleve ATM sipas regjioneve të Kosovës. Nga grafiku konstatohet se pjesa më e madhe e terminaleve ATM është koncentruar në regjionin e Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë mes 5 regjioneve tjera të Kosovës. Arsyet e përqendrimit kaq të madh të terminaleve ATM në regjionin e Prishtinës janë të ndryshme si: numri i madh i banorëve që jetojnë në regjionin e Prishtinës, numri i filialeve të bankave, bizneset që operojnë në këtë regjion, etj.

Figura 12. Shpërndarja e terminaleve ATM nëpër regjione



Burimi: BQK (2015)

Në tabelën në vijim është paraqitur numri i terminaleve POS të instaluar në Kosovë nga viti 2010 deri në vitin 2014. Terminalët POS u mundësojnë klientëve kryerjen e pagesave me kartela pa pasur nevojë për para të gatshme. Kjo është një mënyrë shumë e lehtë dhe e sigurt e kryerjes së pagesave për mallra apo shërbime të ndryshme. Në fund të vitit 2009 numri i terminaleve POS ishte 5.251, ndërsa pas një viti ky numër arriti 6.194 me

normë rritjeje prej 18 për qind. Në vitin 2011 numri i terminalëve POS arriti 7.534 që krahasuar me një vit më parë numri i tyre u rrit me 22 për qind. Ndërsa nëse krahasojmë numrin e POS terminaleve në fund të vitit 2012 me fundin e vitit 2011 do të konstatohet rritje e tyre prej rreth 14 për qind. Në fund të vitit 2013 numri i terminaleve POS arriti në 9,071, që krahasuar me vitin 2012 paraqet rritje prej 5.6 për qind. Po ashtu, edhe gjatë këtij viti numri i terminaleve POS vazhdoi të rritet, që krahasuar me fundin e vitit 2013 paraqet rritje prej rreth 3.1 për qind.


Tabela 7. Numri i terminaleve POS

Terminalet sipas funksionit	2010	2011	2012	2013	2014
Terminale POS (Point of Sale)	6.194	7.534	8,592	9,071	9,349
prej të cilave:					
1 - terminale POS me funksion tërheqje cash	212	1.376	220	215	220
2 - terminale EFTPOS	5,930	6,320	8,499	8,856	9,179

Burimi: BQK (2015)

Në grafikun 13 është paraqitur shpërndarja e rrjetit të terminaleve POS sipas regjioneve të Kosovës. Ngjashëm me shpërndarjen e terminaleve ATM, edhe rrjeti i terminaleve POS është më i përqendruar në regjionin e Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë me pak dallime mes regjioneve të tjera.

Figura 13. Shpërndarja e terminaleve POS nëpër regjione



Burimi BQK (2015)

4. Numri i Kartelave

Në tabelën 8 është paraqitur numri i kartelave sipas funksionit që kryejnë nga viti 2013 deri në tremujorin e katërt të vitit 2014. Në TM4 2014 numri i kartelave me funksion debiti shënoi rritje prej rreth 5.1 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, po ashtu edhe numri i kartelave të kreditit pati trend rritës prej rreth 11.3 për qind. Numri i përgjithshëm i

kartelave në TM4 2014 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar pati rritje prej rreth 5.67 për qind.

Rritja relativisht e shpejtë mund të arsyetohet me faktin se bankat komerciale i kanë kushtuar më shumë rëndësi fushatave informuese për shfrytëzimin e kartelave të kreditit, si dhe mundësitë e reja për pagesa me këste apo forma tjera të pagesës përmes kartelave të kreditit.


Tabela 8. Numri i kartelave sipas funksionit

Kartelat sipas funksionit	2013				2014			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Kartela me funksion cash-i	670,871	702,238	730,812	754,380	731,442	750,878	813,119	813,026
Kartela me funksion pagese	679,017	702,238	730,812	754,380	731,442	750,878	798,996	799,742
prej të cilave:								
1 - Kartela me funksion debiti	581,674	602,899	628,173	645,048	618,926	633,635	679,465	678,090
2 - Kartela me funksion krediti	97,343	99,339	102,639	109,332	112,516	117,243	119,531	121,652
Kartela me funksion para elektronike	13,318	13,589	13,589	15,017	15,125	14,203	14,203	13,284
Numri total i kartelave	692,335	715,827	744,401	769,397	746,567	765,081	813,119	813,026

Burimi BQK (2015)


Në figurat 14 dhe 15 është paraqitur numri i kartelave të debitit dhe kreditit, si dhe numri i përgjithshëm i tyre për disa vite. Kartelat e debitit vazhdojnë edhe më tutje të mbeten në numër më të madh krahasuar me llojet e tjera të kartelave. Kështu në TM4 2014 kartelat e debitit përbënin rreth 83.4 për qind të numrit të përgjithshëm të kartelave, kartelat e kreditit merrnin pjesë me 14.96 për qind, ndërsa kartelat me funksion paranë elektronike përbënin rreth 1.64 për qind të numrit të përgjithshëm të kartelave.

Figura 14. Debit dhe kredit kartelat (në mijëra)



Burimi: BQK (2015)

Figura 15. Numri i përgjithshëm i kartelave (në mijëra)




Burimi: BQK (2015)

Nga numri i përgjithshëm i kartelave në qarkullim, kartelat e markës VISA vazhdojnë të dominojnë tregun, në krahasim me përdorimin e kartelave tjera, të cilat pasohen nga kartelat e markës MasterCard. Numri i kartelave lokale viteve të fundit ka shënuar rënie të vazhdueshme, për shkak të përdorimit të kufizuar të tyre.

Në grafikun në vazhdim është paraqitur shpërndarja e kartelave sipas moshës së poseduesve të tyre. Nga të dhënat e paraqitura në grafik shihet se nga numri i përgjithshëm i poseduesve të kartelave, 15.18 për qind e tyre janë të moshës 18-25 vjeç, 28.47 për qind janë të moshës 26-35 vjeç, 23.25 për qind të moshës 36-45 vjeç, 18.50 për qind të moshës 46-55 vjeç dhe 14.60 për qind të moshës mbi 55 vjeç.


Figura 16. Poseduesit e kartelave sipas moshës



Burimi: BQK (2015)

Në grafikun 17 është paraqitur struktura e mbajtësve të kartelave sipas gjinisë. Nga të dhënat e paraqitura në grafik, mund të konstatohet për shpërndarje joproporcionale të kartelave sipas gjinisë së poseduesve të tyre, me ç'rast, nga numri i përgjithshëm i kartelave, vetëm 28.04 për qind e tyre zotërohen nga femrat, ndërsa pjesa tjetër prej 71.96 për qind zotërohet nga meshkujt.

Figura 17. Poseduesit e kartelave sipas gjinisë



Burimi: BQK (2014)

5. Transaksionet me Kartela

Nga tabela numër 9 mund të shohim lëvizjen e numrit të transaksioneve me kartela gjatë vitit 2013 dhe gjatë vitit 2014 sipas periudhave të rregullta tremujore. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, mund të konstatohet se numri i përgjithshëm i transaksioneve me kartela ka pasur rritje të vazhdueshme përgjatë çdo periudhe.

Kështu gjatë TM1 2014 numri i përgjithshëm i transaksioneve me kartela u rrit për 9.7 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Kjo rritje ka rezultuar nga rritja e numrit të kartelave në qarkullim, si dhe besimi i fituar nga klientët në sigurinë dhe efikasitetin që ofrojnë kartelat.

Në tremujorin e dytë të vitit 2014 numri i përgjithshëm i transaksioneve me kartela u rrit për 10.8 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Numri i tërheqjeve në terminale ATM u rrit për 8 për qind ndërsa numri i transaksioneve me kartela në terminale POS u rrit për 18.8 për qind.

Në tremujorin e tretë të vitit 2014 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 12.5 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Numri i tërheqjeve në terminalet ATM u rrit për 8.4 për qind, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 24.4 për qind.

Në tremujorin e katërt të vitit 2014 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 15.5 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Numri i tërheqjeve në terminalet ATM u rrit për 6.7 për qind, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 37.8 për qind.

Tabela 9. Numri i transaksioneve me kartela

Përshkrimi	2013				2014			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Numri i Transaksioneve prej të cilave:	3,029,903	3,264,376	3,444,217	3,390,578	3,324,599	3,617,691	3,874,485	3,917,414
1 - ATM tërheqje cash	2,120,630	2,294,325	2,436,798	2,399,759	2,245,689	2,478,440	2,640,917	2,561,090
2 - ATM depozitime	912	1,252	1,580	1,570	3,527	4,591	5,553	14,053
3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM	29,656	29,276	26,031	23,345	18,770	18,890	17,690	14,810
4 - Tërheqje cash në terminale POS	3,964	3,995	10,195	3,810	4,011	4,191	3,865	1,266
5 - Pagesa me kartela në terminale POS	874,741	935,528	969,613	962,094	1,052,602	1,111,579	1,206,460	1,326,195

Burimi: BQK (2015)

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 9, shihet se tërheqjet në ATM përbëjnë pjesën më të madhe të transaksioneve me kartela. Në TM4 2014, tërheqjet në ATM përbënin rreth 65.4 për qind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve me kartela, pagesat në POS terminale rreth 33.9 për qind, kredit transferet në ATM rreth 0.38 për qind, tërheqje në POS terminale dhe deponimet cash në ATM rreth 0.32 për qind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve me kartela.

Në tabelën 10 është paraqitur vlera e transaksioneve me kartela gjatë vitit 2013 dhe gjatë vitit 2014 e ndarë sipas periudhave të raportimit. Nga të dhënat në tabelë, shihet se krahas rritjes së numrit të transaksioneve me kartela është rritur edhe vlera e përgjithshme e këtyre transaksioneve.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë, shihet se vlera e përgjithshme e transaksioneve me kartela është rritur për rreth 15.9 për qind, vlera e tërheqjeve në ATM është ngritur për rreth 9.2 për qind, vlera e pagesave në POS terminale është rritur për rreth 40.01 për qind, që paraqet normë mjaft të lartë të rritjes.


Tabela 10. Vlera e transaksioneve me kartela

Përshkrimi	2013				2014			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Vlera e transaksioneve prej të cilave:	233,886,942	273,476,662	356,068,883	292,017,218	261,206,247	303,438,700	358,981,323	338,606,328
1 - ATM tërheqje cash	189,777,903	221,610,163	288,636,998	236,159,208	207,321,268	242,803,650	288,265,856	257,845,346
2 - ATM depozitime	56,595	427,530	901,910	567,240	1,331,075	1,808,930	2,583,985	7,764,643
3 - Kredit Transfere nëpërmjet ATM	219,930	211,187	184,331	165,810	140,399	145,977	124,375	104,706
4 - Tërheqje cash në terminale POS	3,680,094	4,828,627	11,668,447	4,399,116	3,600,391	3,932,916	4,478,684	1,866,595
5 - Pagesa me kartela në terminale POS	40,152,420	46,399,154	54,677,197	50,725,844	48,813,114	54,747,227	63,528,423	71,025,037

Burimi: BQK (2015)

Nga të dhënat në tabelën 10 shihet se tërheqjet në ATM përbëjnë rreth 76.1 për qind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela, pagesat në POS terminale përbëjnë rreth 20.9 për qind, ndërsa kredit transferet përmes ATM-ve, deponimet cash në ATM dhe tërheqjet në POS terminale përbëjnë rreth 3 për qind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela.


Figura 18. Pjesëmarrja e transaksioneve me kartela sipas numrit dhe sipas vlerës



Burimi: BQK (2015)

Nga grafiku 19 konstatohet për numrin e vogël të kartelave aktive. Nga grafiku shihet se vetëm 54.41 për qind e kartelave të debitit janë aktive në terminale POS apo ATM, ndërsa sa u përket kartelave të kreditit, rreth 56.57 për qind e tyre janë aktive.

Figura 19. Kartelat aktive



Burimi: BQK (2015)

Përfundim

Bazuar në hulumtimin dhe analizën e raportit të fundit tremujor mbi instrumentet dhe terminalët e pagesave në Kosovë, mund të konstatohet për përmirësim të infrastrukturës së pagesave, rritje të vazhdueshme të numrit të instrumenteve të pagesave dhe njëkohësisht ngritje në përdorimin e këtyre instrumenteve.

Rritja e numrit të terminaleve për pagesa POS dhe ATM, si dhe shtrirja e tyre në shumë zona të vendit ka rezultuar edhe në rritje të numrit të kartelave në zotërim nga qytetarët, njëkohësisht duke ndikuar në rritjen e numrit dhe vlerës së transaksioneve të kryera me kartela. Duhet theksuar se rritja e numrit dhe vlerës së transaksioneve me kartela gjatë kësaj periudhe ka pasur ngritje më të shpejt krahasuar me periudhat e kaluara, e veçanërisht numri dhe vlera e pagesave në POS terminale.

Trendi i lartë i rritjes së numrit dhe po ashtu përdorimit të instrumenteve të pagesave do të ndikojë në reduktimin e transaksioneve të kryera me para të gatshme. Rritja e mëtejme e përdorimit të instrumenteve për pagesa elektronike, do të zvogëlojë sasinë e parasë së gatshme në qarkullim dhe do të rritë sigurinë dhe efikasitetin në kryerjen e pagesave.

Bazuar në vlerësimet si më lartë, shihet se Kosova ka perspektivë të mirë sa i përket përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Mosha mesatare mjaft e re e popullsisë në Kosovë, si dhe niveli i njohurive për teknologjinë e re lejojnë të besohet se pagesat elektronike do të jenë faktorë shumë i rëndësishëm në zvogëlimin e pagesave me para të gatshme, si dhe formave tradicionale të transfereve të bazuar në letër.

Pra, mund të konstatohet se ka ende hapësira për përmirësim të politikave dhe mekanizma të tjerë për të rritur përdorimin e instrumenteve të reja elektronike të pagesave.